



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot
DPK	03-02/2909
Nr. llog Broj stranica	Data Datum
02	29-09-2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.09.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-601/17 për z.Avdylkadër Muçaj, Drejtor i Departamentit Ligjorë në Autoritetin rregullativ të Hekurudhave për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I.Rasti i hapur me numër protokolli AKK-03-02-601/17, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z.Avdylkadër Muçaj, Drejtor i Departamentit Ligjorë në Autoritetin rregullativ të Hekurudhave. Inicimi i këtij rasti është bërë pas denoncimit nga një palë e tretë me dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik. Dyshimi për situatë të konfliktit të interesit, sipas denoncuesit, kishte të bëjë me zyrtarin e lartë z.Avdylkadër Muçaj, i cili ka nën mbikëqyrje gruan e vet si zyrtare ligjore në këtë institucion pra në departamentin ku punojnë.

Agjencia kundër Korrupsionit lidhur me këtë rastë ka zhvilluar procedurën e paraparë për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas procedurës zyrtarit të lartë z.Muçaj i ka dërguar shkresë njoftuese zyrtarit në fjalë ku e ka njoftuar për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të interesit. Më pastaj është organizuar një takim me zyrtarin z.Muçaj, gjatë takimit zyrtari kompetent nga Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar me situatën për të cilën është iniciuar procedura ndaj tij.

Në këtë takim zyrtari i lartë z.Avdylkadër Muçaj, Drejtor i Departamentit Ligjorë në Autoritetin rregullativ të Hekurudhave, ka deklaruar se nuk qëndron në hierarki me gruan e tij, për të cilën gjë ka ofruar edhe dëshmi, duke prezantuar një vendim qe tregon se znj.Dije Ramabaja, është transferuar në Departamentin e Rregullimit të Tregut si u.d Monitorues e Rregullimit të



Tregut në ARH-ë me vendim të u.d. Drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës z. Shkelzen Qorri (Vendimi Nr.03/2017- 02/418).

Po ashtu Agjencia duke dashur të vërtetoj gjendjen lidhur me këtë rast ka kërkuar nga Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës që ta njoftoj AKK-ën, se nga cila periudhë ka filluar punën zyrtarja znj. Dije Ramabaja, dhe në çfarë pozite dhe në cilin Departament. Nga ky Institucion kemi pranuar shkresën njoftuese ku na kanë njoftuar se në bazë të evidencave të njesisë së personelit znj. Dije Ramabaja ka filluar punën në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave me datën 10.01.2011 si Asistente e Administratës në Departamentin e Administratës me Kontratë mbi Shërbimet (vepër), ndërsa momentalisht ushtron pozitën si u.d Zyrtare e Lartë për Rregullimin e tregut Hekurudhor në Kuadër të ARH-s.

Nga informatat dhe dokumentacionit që kemi pasur në dispozicion lidhur me rastin në fjalë është vërtetuar se zyrtari i lartë z. Avdylkader Muçaj, Drejtor i Departamentit Ligjorë në Autoritetin rregullativ të Hekurudhave nga data 31.03.2017 nuk punojnë në të njëjtin Departament dhe nuk qëndron në hierarki me znj. Dije Ramabaja, me të cilën ka lidhje bashkëjetese, pasi që e njëjta është transferuar në Departamentin e Rregullimit të Tregut në këtë Institucion si u.d Monitorues e Rregullimit të Tregut në ARH me vendim të u.d. Drejtori i përgjithshëm të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës z. Shkelzen Qorri (Vendimi Nr.03/2017-).

Duke vlerësuar informatat dhe dokumentacionit lidhur me këtë rast kemi ardhë në përfundim se z. Avdylkader Muçaj, Drejtor i Departamentit Ligjorë në Autoritetin rregullativ të Hekurudhave nuk qëndron në hierarki dhe nuk ka marrëdhënie varsie me znj. Dije Ramabaja në pozitë të tyre ku punojnë në ARH-ë që do të mundë të ndikoj në paanshmërinë dhe shprehje të vullnetit të lirë dhe që do të mundë të shkaktoj edhe konflikt të interesit të paraparë në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, si dhe mos rrespektim të parimeve të përgjithshme të veprimit dhe mos veprimit të paraparë në nenin 7 të ligjit Nr.04/L- 051, Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /

